



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

KOMISIONI I DHËNIES SË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

Nr _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2020

SHTOJCË

PËR PEZULLIMIN E PROCEDURËS SË KONCESIONIT/PPP

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është duke ndjekur me shqetësim situatën e krijuar për shkak të përhapjes së koronavirusit COVID-19, i cili ka prekur edhe Shqipërinë. Me me anë të Vendimit nr. 243, datë 24.3.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatëkeqësisë natyrore” është shpallur gjendja e fatëkeqësisë natyrore. Gjithashtu, në nivel ndërkombëtar, Organizata Botërore e Shëndetësisë ka shpallur gjendjen e pandemisë.

Planet e masave të marra në Republikën e Shqipërisë, si edhe në shumë shtete, për ndalimin e përhapjes së koronavirusit COVID-19 kanë ndikuar në shumë sektorë të ekonomisë. Projekti për “Dhënie me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit të Vlorës” është një projekt strategjik dhe me rëndësi të veçantë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë. Procedura për përzgjedhjen e fituesit, në cilësinë e një *Procedure të Hapur, Ndërkombëtare* është ndërtuar mbi parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit, trajtimit të barabartë, reciprocitetit dhe të sigurisë juridike.

Në rastin konkret, me pjesëmarrjen në procedurën e koncesionit/PPP operatorët ekonomikë duhet të dorezojnë dokumentacion në drejtim të përmbushjes së kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/ pranimit, kapacitetit ligjor, ekonomik dhe teknik. Përgatitja e dokumentacionit në kuadër të pjesëmarrjes në procedurë krahas vullnetit të operatorëve ekonomike përfshin bashkëveprimin e domosdoshëm me administratën shtetërore, gjyqësore ose subjekte të tjera juridike. Situata e krijuar ka përfshire rrethanat të cilat janë të pazakonta, të paparashikueshme dhe përtej kontrollit të subjekteve juridike publike dhe private duke krijuar vështirësi të

pakapërcyeshme për përmbushjen e detyrimeve juridike të cilat nuk mund të ishin shmangur edhe sikur të ishte ushtruar gjithë kujdesi i duhur.

Në kushtet e masave strikte dhe kufizuese, autoriteti kontraktues e vlerëson të nevojshme pezullimin e zhvillimit të procedurës deri në një vendimarrje të detyrë të bazuar në parimin e proporcionalitetit, si masë nxitëse për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e dhënies së koncesionit/PPP, si niveli më i lartë i aplikimit të parimit të transparencës, mos diskriminimit dhe trajtimit të barabartë mes ofertuesve të regjistruar në vende të cilat nuk kanë zbatuar masa strikte në sektorë të ekonomisë dhe të atyre që kanë aplikuar.

Autoriteti kontraktues, gjatë kësaj periudhe ka marrë të gjithë masat e nevojshme për të shtyrë afatin e procedurës së dhënies së koncesionit/PPP, por duke qenë se referuar të dhënave zyrtare nga organet shtetërore përgjegjëse në nivel kombëtar dhe informacionit në nivel ndërkombëtar, një afat i pritshëm i përfundimit të masave parandaluese nuk është i mundur, atëherë krijimi i pritshmërisë së ligjshme për datën e zhvillimit të procedurës me shtyrje të shpeshta të saj krijon konfuzion për operatorët ekonomikë si edhe cënon parimin e sigurisë juridike.

Sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, të ndryshuar, ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Vendimit nr. 243, datë 24.3.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatëkeqësisë natyrore”, Njoftimit Nr. 2339, protokollin datë 27.03.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik”, autoriteti kontraktues *Pezullon pa afat* procedurën e dhënies së koncesionit/PPP, si masë proporcionale për mbrojtjen e interesit më të lartë publik.

KOMISIONI I DHËNIES SË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT